



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 934/2prot.,

Datë 03.05.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Lurimi” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me Nr. REF-54455-12-20-2022, me objekt: “*Hartimi i planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore ZallHerr-Priskë*” në pronësi të Bashkisë Tiranë” me fond limit 5,096,000lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues: “Lurimi” SHPK
Lagjia: “Drita”, Burrel

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë
Tiranë

Në datën 02.05.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 934/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3066 e operatorit ekonomik “Lurimi” SHPK për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence”, me Nr. REF-54455-12-20-2022, me objekt: “Hartimi i planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore ZallHerr-Priskë” në pronësi të Bashkisë Tiranë” me fond limit 5,096,000lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Lurimi” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Lurimi” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 934/2023 prot., datë 08.06.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3066

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Në dokumentat standarte të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: “Hartimi i planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore ZallHerr-Priskë” në pronësi të Bashkisë Tiranë” me Nr REF-54455-12-20-2022 dhe konkretisht në fund të përcaktimeve të bëra për kriteret e vecanta për kualifikim është përcaktuar si më poshtë vijon: “Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorëve ekonomikë të kualifikuar që të dorëzojnë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”. Në vijim në nenin 26 pika 6 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) është përcaktuar gjithashtu se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”. Tek kriteret e përgjithshme gërma (e) korrespondon me kërkesën për paraqitjen e dokumentacionit që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Operatori ekonomik “Lurimi” shpk i kualifikuar për fazën parakualifikuese konkretisht në listën e shkurtër ka paraqitur dokumentacionin provues sipas përcaktimit të bërë në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit si edhe në përcaktimin e bërë në nenin 26 pika 6 e VKM-së Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) . Komisioni i Vlerësimit të ofertave pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar në dt 24.04.2023 me anë të shkresës Nr.15844 prot pranë Bashkisë Tiranë konstaton se përmban mangësitë si më poshtë vijon: Operatori ekonomik “Lurimi” shpk për të vërtetuar se ka paguar energjinë elektrike ka paraqitur dokumentacionin provues “Vërtetim Debie” Nr 857 Prot dt 01.11.2022 të lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sha Burrel në të cilën citohet se: “.....nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në dt. 01.11.2022 pa

përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2022 për dy kontrata (privat) edhe një kontratë (familjare)....”. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.” Nisur nga sa me sipër anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave gjykojnë se, dokumentacioni provues i paraqitur nga operatori ekonomik “Lurimi” sh.p.k nuk jep informacion për muajin e fundit të maturuar të energjisë elektrike pra të muajit Nëntor madje nuk përfshin në të as pagesën për muajin Tetor i cili duhet të ishte i përfshirë për sa kohë është bërë edhe vetdeklarimi për shlyerjen e tyre. Konkretisht, rezulton se operatori ekonomik “Lurimi” sh.p.k referuar dokumentit provues nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike sipas përcaktimeve ligjore në fuqi në momentin kur ka bërë vetdeklarimin për shlyerjen e detyrimeve për energjinë elektrike. Nga dokumentacioni i mësipërm konstatohet se shoqëria “Lurimi” sh.p.k rezulton të ketë të papaguar faturën e muajit Tetor edhe Nëntor. Lidhur me këtë fakt, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjykon se operatori ekonomik “Lurimi” sh.p.k duhet të paraqiste vërtetimin e debisë ose çdo dokumentacion tjetër provues që vërteton se ka shlyer detyrimet për muajin Nëntor, pasi hapja e ofertave është bërë në datën 04.01.2023, kohë në të cilën operatori ekonomik në fjalë kishte mundësinë e likuidimit të faturës së energjisë elektrike për muajin Nëntor 2022 në mënyrë që të provonte se përmbushte atë ç’ka kishte vetdeklaruar pra duhet të dispononte një fotografi të momentit që të vërtetonte se dokumentacioni provues përputhet me vetdeklarimin e kryer për këtë pikë në ditën e hapjes së ofertave. Operatori ekonomik “Lurimi” shpk, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, nuk ka vërtetuar/provuar se në momentin e vetdeklarimit ka shlyer të gjitha detyrimet e matuara të energjisë elektrike, përfshirë edhe detyrimet për muajin Nëntor 2022, data maksimale përfundimtare për shlyerjen e të cilit, mbështetur në nenin e sipërcituar, ishte data 31.12.2022. Në Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 përcaktohet se: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore..... jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar”ç’ka do të thotë se afati 31.12.2022 është dita e fundit për shlyerjen e këtij detyrimi. Ofertuesit e mundshëm dhe në rastin konkret shoqëria “Lurimi” shpk i cili ka shprehur interesin për të marrë pjesë në këtë procedurë dhe ka vetdeklaruar për shlyerjen e këtyre detyrimeve presupozohet se e ka kryer likuidimin e detyrimit për muajin Nëntor 2022 pasi detyrimi nuk mund të shlyhet pas datës 31.12.2022. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 03.05.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro